



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 839/5 Prot.

Tiranë, më 10.06.2025

REKOMANDIM

Nr. 28, datë 10.06.2025

**PËR KONTROLLUESIN LABORATORI “CAMBRIDGE CLINICAL
LABORATORIES”**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “*Ligji*”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “*Kodi i Procedurave Administrative*”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit Laboratori “*Cambridge Clinical Laboratories*”, Tiranë (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 49, datë 05.03.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nipt M01317022A dhe ushtron aktivitetin në fushën e shërbimeve diagnostike si: “*Laborator mjekësor, klinik biokimik, mikrobiologjik dhe gjenetik, biokimike, imunologjik, hormonele, menaxhimin e transportin sipas standardeve mjekësore*”

përkatëse të Stem Cell. Import-export i aparaturave dhe paisjeve elektromjekësore, ekzaminuese reagent etj.”

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “pacientë”; “staf administrativ”; “mjek”; “infirmier” etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik dokumentacionin për stafin administrativ aktual dhe të larguar. Konstatohet se, në dosjet e personelit të larguar ruhen kopje të dokumentacionit personal si “vërtetim i gjendjes gjyqësore”, “kopje e letërnjoftimit”, “jetëshkrim” (CV).

Të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen, pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Gjithashtu, konstatohet se në dosjet e personelit të larguar si dhe në dosjet e personelit aktual ruhet ndër të tjera, certifikata e vaksinimit COVID 19, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa shtesë të sigurisë së përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 28 të Ligjit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive, e sidomos të dhënave të lidhura me shëndetin. Mungesa e rregullimit të qartë për këto kategori të dhënash përbën cenim për përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

3. Konstatohet se, kontrolluesi nuk aplikon për pacientët “Formular Pëlqimi”. Subjektet e të dhënave nuk informohen në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave

personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 13 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

4. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të ushtrimit të veprimtarisë së tij. Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, kontrolluesi nuk disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, në kundërshtim me parashikimin e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 30.04.2025 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejit”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 3”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejitimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejitimit, të miratuar nga Komisioneri.

5. Konstatohet se, Cambridge Clinical Laboratories, ka lidhur *“Kontratë shërbimi”*, datë 01.01.2024, me objekt *“Ofrimi i shërbimeve IT”*, në të cilën Cambridge Clinical Laboratories është në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe *“BST”* në cilësinë e kontraktuesit.

Gjithashtu, kontrolluesi ka lidhur kontratë bashkëpunimi me Shoqërinë *“Intermedica Center”* sh.p.k, nr. 151 prot., datë 01.11.2022 me objekt *“Për kryerjen e ekzaminimeve laboratorike klinike, biokimike, hormonale, bakteriologjike, citologjike, parazitologjike etj.”*, si dhe marrëveshje bashkëpunimin datë 11.12.2022, me emërtimin *“Private Cooperation Agreement”* lidhur me laboratorin *“Mycroanalysis Private Medical Diagnostics Laboratories”* me vendndodhje në Greqi, me objekt kryerjen e analizave dhe testeve laboratorike mikrobiologjike.

Nga analizimi i përmbajtjes së kontratave/marrëveshjeve të mësipërme konstatohet se në to, nuk specifikohen masat konkrete teknike-organizative të detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, si dhe nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”* i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një akt/kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me nenin 26 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash) sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një rregulloreje “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” përbën një detyrim thelbësor ligjor për çdo kontrollues, në zbatim të nenit 28 të Ligjit. Kjo rregullore duhet të përmbajë në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të kontrolluesit.

7. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr.47*”) për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore më datë 29.04.2025, organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26, 28, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale, si dhe të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të hartojë rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, veçanërisht të dhënave sensitive, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të “Cambridge Clinical Laboratories”;
3. Kontrolluesi, të përfshijë në kontratë dhe/ose aneks kontratë, të nënshkuar mes kontrolluesit dhe përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit;

4. Kontrolluesi, të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese në ambientet e survejuara përmes sistemit CCTV, sipas modelit standard të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre;
6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 5 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 4 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 3 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 2 më sipër;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
8. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 10.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi